

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
KRYETARI

Nr. 189/5 Prot.

Tiranë, më 29/06/2016

V E N D I M

Nr. 70, Datë 29/06/2016

PËR

EVADIMIN E MATERIALEVE TË AUDITIMIT TË USHTRUAR NË ZYRËN VENDORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME BERAT “PËR ZBATIMIN E PROCEDURËS LIGJORE NË PRANIMIN DHE ADMINISTRIMIN E DOKUMENTACIONIT TEKNIKO-LIGJOR PËR REGJISTRIMIN FILLESTAR TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, EVIDENTIMIN DHE TRAJTIMIN LIGJOR TË MBIVENDOSJEVE”.

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe projekt vendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Administrimit të Aseteve, të Kontrollit të Territorit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, mendimin për cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit Juridik, Sigurimit të Standardeve dhe Etikës, vlerësimin mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të Auditimit të Administrimit të Aseteve, të Kontrollit të Territorit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, në mbështetje të neneve 10, 15, dhe 30, të Ligjit nr. 154, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”,

V E N D O S A:

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit “Për zbatimin e procedurës ligjore në pranimin dhe administrimin e dokumentacionit tekniko ligjor për regjistrimin fillestar të pasurive të paluajtshme, evidentimin dhe trajtimin ligjor të mbivendosjeve”, të ushtruar në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Berat, për periudhën 01.01.2013 deri më 31.12.2015.

II. Të miratoj rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkoj marrjen e masave, për sa vijon:

A. MASA ORGANIZATIVE

1 - Gjetje nga auditimi: ZVRPP Berat nuk ka hartuar program pune dhe nuk ka zbatuar rekomandimet e lëna nga KLSH, veprim në papajtueshmëri me germën **j** dhe **k** të nenit 15 dhe nenin 30, të Ligjit nr. 154, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” dhe Urdhrin e Kryeministrit nr. 70, datë 18.04.2006 “Për masat

në zbatimin e rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit, Auditit të Brendshëm dhe Departamentit të Kontrollit të Brendshëm Administrativ dhe Antikorrupsion, në Këshillin e Ministrave, në institucionet në vartësi të Kryeministrit apo Ministrive” (Trajtuar në faqet 20-20, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

- **Rekomandim:** Regjistruesi i ZVRPP Berat të marrë masa dhe të hartojë program pune për të zbatuar rekomandimet e lëna nga KLSH, duke vendosur kufizimet përkatëse për të gjitha raste e rekomanduara nga KLSH-ja me shkresë nr. 923/6, datë 06.02.2006.

Brenda muajt Gusht 2016

2 - Gjetje nga auditimi: Në ZVRPP Berat për periudhën 2013-2015, kanë ardhur për regjistrim **13,850 kërkesa**, janë punuar brenda afatit **10,098 kërkesa** ose **73 %** e tyre dhe janë punuar jashtë afatit **3,752 kërkesa** ose **27%** e tyre, veprim në papajtueshmëri me paragrafin e dytë pika 1 neni 70, të Ligjit nr. 33, datë 21.03.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” (Trajtuar në faqet 246-248, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

- **Rekomandim:** Regjistruesi i ZVRPP Berat të marrë masa, që kërkesat e ardhura për regjistrimin e pasurive të paluajtshme nga qytetarët t’i kryejë brenda afatit të përcaktuar në aktet ligjore dhe nënligjore në zbatim, si dhe të përcaktojë normën e ngarkesës ditore për çdo punonjës.

Menjëherë

3 - Gjetje nga auditimi: ZVRPP Berat në **2 raste**, ka regjistruar në kartelën e pasurisë së paluajtshme dhe ka lëshuar certifikatë pronësie për pasuri “Oborr në përdorim”, **duke regjistruar më shumë truall me sipërfaqe 700 m²**, veprim në papajtueshmëri me nenin 45, të Ligjit nr. 33, datë 21.03.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, pika 5, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012 “Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit” dhe germa ç pika 8, të VKM nr. 578, datë 29.08.2012 “Për përcaktimin e procedurës së kalimit në pronësi të oborreve në përdorim”, të ndryshuar (Trajtuar në faqet 21-22, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

- **Rekomandim:** Regjistruesi i ZVRPP Berat të marrë masa, që në bazë të pikës 1 neni 5, pikës 1 neni 49 dhe nenit 59, të Ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë nr. 1/732, volum 12, faqe 218 dhe pasurinë nr. 1/268, volum 6, faqe 51, ZK 3682, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor.

Brenda muajt Gusht 2016

4 - Gjetje nga auditimi: ZVRPP Berat, në **1 rast**, ka regjistruar në kartelën e pasurisë së paluajtshme dhe ka lëshuar certifikatë pronësie për Arë me sipërfaqe **325 m² pasuri e cila nuk ndodhet në AMTP nr. 385, datë 20.05.1992**, veprim në papajtueshmëri me nenin 25/a, të Ligjit nr. 33, datë 21.03.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, germa ç pika 1, të UKM nr. 2, datë 13.06.2013 “Për mënyrën e procedimit të organeve të administratës publike, për pasuritë e paluajtshme, të fituara me Aktin e Marrjes së Tokës në Pronësi (AMTP)” (Trajtuar në faqet 31-32, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

- **Rekomandim:** Regjistruesi i ZVRPP Berat të marrë masa, që në bazë të pikës 1 neni 5, pikës 1 neni 49 dhe neni 59, të Ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë nr. 743/37, volum 6, faqe 97, ZK 2381, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor.

Brenda muajt Gusht 2016

5 - Gjetje nga auditimi: ZVRPP Berat, në **1 rast**, ka regjistruar në kartelën e pasurisë së paluajtshme dhe ka lëshuar certifikatë pronësie për Arë me sipërfaqe **280 m² përfituar më shumë** si diferencë ndërmjet LN dhe AMTP nr. 18, datë 20.09.1992 (LN 15280 m² - AMTP

15000 m²). Ngastra me emërtimin popullor “Dushku i kuq”, (Ullishte) me sipërfaqe 500 m² nuk ka të përcaktuar kufizimet përkatëse, veprim në papajtueshmëri me nenin 25/a, të Ligjit nr. 33, datë 21.0.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, germa ç pika 1, të UKM nr. 2, datë 13.06.2013 “Për mënyrën e procedimit të organeve të administratës publike, për pasuritë e paluajtshme, të fituara me Aktin e Marrjes së Tokës në Pronësi (AMTP)” (*Trajtuar në faqet 32-34, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

- **Rekomandim:** Regjistruesi i ZVRPP Berat të marrë masa, që në bazë të pikës 1 neni 5, pikës 1 neni 49 dhe neni 59, të Ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë nr. 20/2/87, volum 3, faqe 244, nr. 20/2/88, volum 3, faqe 245, nr. 21/6/11, volum 3, faqe 242, nr. 21/6/12, volum 3, faqe 243, nr. 91/6/12, volumin 3, faqe 101, ZK 2381, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor.

Brenda muajt Gusht 2016

6 - Gjetje nga auditimi: ZVRPP Berat, në **1 rast**, ka regjistruar në kartelën e pasurisë së paluajtshme dhe ka lëshuar certifikatë pronësie për Arë me sipërfaqe **250 m² përfituar më shumë** si diferencë ndërmjet LN dhe AMTP nr. 38, datë 20.09.1992 (LN 25310 m² - AMTP 25060 m²), veprim në papajtueshmëri me nenin 25/a, të Ligjit nr. 33, datë 21.0.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, germa ç pika 1, të UKM nr. 2, datë 13.06.2013 “Për mënyrën e procedimit të organeve të administratës publike, për pasuritë e paluajtshme, të fituara me Aktin e Marrjes së Tokës në Pronësi (AMTP)” (*Trajtuar në faqet 34-35, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

- **Rekomandim:** Regjistruesi i ZVRPP Berat të marrë masa, që në bazë të pikës 1 neni 5, pikës 1 neni 49 dhe neni 59, të Ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë nr. 20/2/84, volum 3, faqe 237, nr. 20/2/83, volum 1, faqe 144, nr. 17/10, volum 3, faqe 49, nr. 21/1/10, volum 1, faqe 218, nr. 147/14, volumin 2, faqe 200, nr. 148/28, volum 2, faqe 237, nr. 144/1/6, volum 3, faqe 230, nr. 144/1/37, volum 3, faqe 231, nr. 144/1/38, volum 3, faqe 232, nr. 21/6/8, volum 3, faqe 233, nr. 21/6/9, volum 3, faqe 234 nr. 21/6/10 volum 3, faqe 235, ZK 2381, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor.

Brenda muajt Gusht 2016

7 - Gjetje nga auditimi: ZVRPP Berat, në **1 rast**, ka regjistruar në kartelën e pasurisë së paluajtshme dhe ka lëshuar certifikatë pronësie për Arë me sipërfaqe **960 m² përfituar më shumë** si diferencë ndërmjet LN dhe AMTP nr. 1, datë 20.09.1992 (LN 19430 m² - AMTP 1840 m²), veprim në papajtueshmëri me nenin 25/a, të Ligjit nr. 33, datë 21.0.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, germa ç pika 1, të UKM nr. 2, datë 13.06.2013 “Për mënyrën e procedimit të organeve të administratës publike, për pasuritë e paluajtshme, të fituara me Aktin e Marrjes së Tokës në Pronësi (AMTP)” (*Trajtuar në faqet 36-37, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

- **Rekomandim:** Regjistruesi i ZVRPP Berat të marrë masa, që në bazë të pikës 1 neni 5, pikës 1 neni 49 dhe neni 59, të Ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë nr. 145/17, volum 2, faqe 139, nr. 91/11, volum 3, faqe 100, nr. 21/1/42, volum 1, faqe 250, nr. 21/1/20, volum 1, faqe 228, nr. 20/2/18, volum 2, faqe 159, nr. 147/7, volum 2, faqe 193, ZK 2301, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor.

Brenda muajt Gusht 2016

8 - Gjetje nga auditimi: ZVRPP Berat, në **1 rast**, ka regjistruar në kartelën e pasurisë së paluajtshme dhe ka lëshuar certifikatë pronësie për pasuri të fituar sipas Aktit të Marrjes së Tokës në Pronësi nr. 39, **pa datë**, me sipërfaqe **5,640 m²**, ku **mungon njëra nga vulat**, ndërsa ngastra nr. 1738, pemëtore me sipërfaqe 1,020 m², nr. 1738, pemëtore me sipërfaqe

1,120 m² dhe nr. 1738, vresht me sipërfaqe 3,500 m² janë pa kufizimet përkatëse, veprim në papajtueshmëri me germa ç pika 1, të UKM nr. 2, datë 13.06.2013 “Për mënyrën e procedimit të organeve të administratës publike, për pasuritë e paluajtshme, të fituara me Aktin e Marrjes së Tokës në Pronësi (AMTP)” (Trajtuar në faqet 38-39, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

- **Rekomandim:** Regjistruesi i ZVRPP Berat të marrë masa, që në bazë të pikës 1 neni 5, pikës 1 neni 49 dhe neni 59, të Ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë nr. 67/24, volum 4, faqe 81 dhe pasuria nr. 67/25, volum 4, faqe 82, ZK 1004, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor.

Brenda muajt Gusht 2016

9 - Gjetje nga auditimi: ZVRPP Berat në 10 raste, me sipërfaqe 28,820 m² ka bërë regjistrimin e pasurisë të paluajtshme dhe ka lëshuar certifikata pronësie për pasuri të fituara me Akt Marrje Toke në Pronësi (AMTP), pasi në akte janë regjistruar pasuri të cilat nuk janë përfituar me Ligjin nr. 7501, datë 17.09.1991 “Për tokën”, veprim në papajtueshmëri me neni 25/a, të Ligjit nr. 33, datë 21.03.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” dhe pika 1, të UKM nr. 2, datë 13.06.2013 “Për mënyrën e procedimit të organeve të administratës publike, për pasuritë e paluajtshme, të fituara me Aktin e Marrjes së Tokës në Pronësi (AMTP)” (Trajtuar në faqet 41-42, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

- **Rekomandim:** Regjistruesi i ZVRPP Berat të marrë masa, që në bazë të pika 1 neni 5, pika 1 neni 49 dhe neni 59, të Ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë nr. nr. 9/285, volum 12, faqe 210, nr. 7/264, volum 13, faqe 11, nr. 7/265, volum 13 faqe 12, nr. 7/266, volum 13 faqe 13, nr. 8/30, volum 7, faqe 190, nr. 3/46, volum 7, faqe 113, nr. 8/6, volum 7, faqe 114, nr. 8/159, volum 7, faqe 115, nr. 6/16, volum 7, faqe 102, nr. 8/56, volum 7, faqe 202, nr. 8/162 volum 7, faqe 204, nr. 8/58, volum 7, faqe 203, nr. 5/11, volum 7, faqe 123, nr. 5/14, volum 7, faqe 124, nr. 5/11, volum 7, faqe 123, nr. 5/131, volum 7, faqe 157, nr. 1/96, volum 7, faqe 99, ZK 3682, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor.

Brenda muajt Gusht 2016

10 - Gjetje nga auditimi: ZVRPP Berat në 1 rast, ka regjistruar në kartelën e pasurisë së paluajtshme dhe ka lëshuar certifikatë pronësie për sipërfaqen 521 m² përfituar më shumë si diferencë ndërmjet LN dhe AMTP nr. 151, datë 04.09.1996 (LN 5320 m² - AMTP 4800 m²), veprim në papajtueshmëri me nenin 25/a, të Ligjit nr. 33, datë 21.0.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” dhe germa ç pika 1, të UKM nr. 2, datë 13.06.2013 “Për mënyrën e procedimit të organeve të administratës publike, për pasuritë e paluajtshme, të fituara me Aktin e Marrjes së Tokës në Pronësi (AMTP)” (Trajtuar në faqet 52-53, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

- **Rekomandim:** Regjistruesi i ZVRPP Berat të marrë masa, që në bazë të pikës 1 neni 5, pikës 1 neni 49 dhe neni 59, të Ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë nr. 800/1, volum 6, faqe 222, ZK 8505, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor.

Brenda muajt Gusht 2016

11 - Gjetje nga auditimi: ZVRPP Berat në 3 raste, ka regjistruar në kartelën e pasurisë së paluajtshme dhe ka lëshuar certifikatë pronësie për pasuri të përfituara me Akt Marrje Toke në Pronësi, pasi mungon njëra nga vulat. Gjithashtu ka përfituar më shumë Ullishte me sipërfaqe 655 m², si diferencë ndërmjet (LN 8655 m² - AMTP 8000 m²), veprim në papajtueshmëri me nenin 25/a, të Ligjit nr. 33, datë 21.03.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, me germa ç pika 1, të UKM nr. 2, datë 13.06.2013 “Për mënyrën e procedimit të organeve të administratës publike, për pasuritë e paluajtshme, të fituara me Aktin e Marrjes

së Tokës në Pronësi (AMTP)” (Trajtuar në faqet 55-56, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

- **Rekomandim:** Regjistruesi i ZVRPP Berat të marrë masa, që në bazë të pikës 1 neni 5, pikës 1 neni 49 dhe neni 59, të Ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë nr. 370, volum 2, faqe 171, nr. 583, volum 3, faqe 170, nr. 598/5, volum 3, faqe 191, nr. 706/7, volum 4, faqe 38 dhe pasuria nr. 714, volum 4, faqe 45, ZK 8505, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor.

Brenda muajt Gusht 2016

12 - Gjetje nga auditimi: ZVRPP Berat në **1 rast**, ka bërë regjistrimin pasurisë së paluajtshme të fituar me leje ndërtimi, pasi në vendimin e KRRT-së nr. 5, datë 07.12.1994, për miratimin e kondicioneve urbane të tij, **nuk është përcaktuar sipërfaqja e ndërtimi, si dhe nuk mban vulën e Këshillit të Rrethit Berat**, veprim në papajtushmëri me nenin 48, të Ligjit nr. 33, datë 21.03.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, pikën 5, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012 “Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrat të regjistruesit” dhe germa **a** dhe **b** pika 2 neni 107 dhe germa **c** neni 116, të Ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Proceduarve Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar. (Trajtuar në faqet 156-157, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

- **Rekomandim:** Regjistruesi i ZVRPP Berat të marrë masa, që në bazë të pikës 1 neni 5, pikës 1 neni 49 dhe neni 59, të Ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë nr. 985/32, volumin 14, fleta 53, ZK 2381, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor.

Brenda muajt Gusht 2016

13 - Gjetje nga auditimi: ZVRPP Berat në **1 rast**, ka bërë regjistrimin e pasurisë së paluajtshme të përfituar me leje ndërtimi **në zërin kadastral rrugë**. Akt Kolaudimi është **pa datë** dhe nuk ka përcaktuar afatin e fillimit dhe të përfundimit të punimeve të objektit, lejen e sheshit të ndërtimit dhe lejen e ndërtimit, marrdhëniet me truallin, si dhe mungon: vendimi i KRRT për miratimin e sheshit të ndërtimit dhe të kondicioneve urbane të tij, (formulari nr. 2); planvendosja e objektit dhe leja e përdorimit lëshuar nga Drejtoria e Urbanistikës ish-Komuna Otlak, veprim në papajtushmëri me nenin 24 dhe pika 1 neni 48, të Ligjit nr. 33, datë 21.03.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” dhe pika 12, të Rregullores nr. 184, datë 08.04.1999 “Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme”, të ndryshuar, për vitet 1993-1995 (Trajtuar në faqet 157-159, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

- **Rekomandim:** Regjistruesi i ZVRPP Berat të marrë masa, që në bazë të pikës 1 neni 5, pikës 1 neni 49 dhe neni 59, të Ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë 859/12-ND, volumin 16, fleta 149, ZK 2381, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor.

Brenda muajt Gusht 2016

14 - Gjetje nga auditimi: ZVRPP Berat në **2 raste**, ka regjistruar pasurinë e paluajtshme dhe ka lëshuar certifikatë pronësie për pasurinë nr. 2/637-ND, volum 7, faqe 31 dhe pasurinë nr. 1/288-ND, volum 7, faqe 48, pasi në **Seksionin “E” të kartelës së pasurisë së paluajtshme është vendosur kufizimi**. Në lejen e ndërtimit nuk është përcaktuar sipërfaqja e sheshit dhe sipërfaqja e ndërtimit dhe mungojnë **marrëdhëniet me truallin**, veprim në papajtueshmëri me nenin 59, të Ligjit nr. 33, datë 21.03.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” (Trajtuar në faqet 159-160, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

- **Rekomandim:** Regjistruesi i ZVRPP Berat të marrë masa, që në bazë të pikës 1 neni 5, pikës 1 neni 49 dhe neni 59, të Ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë 2/637-

ND, volumin 7, fleta 31 dhe nr. 1/288-ND, volumin 7, fleta 48, ZK 3682, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor.

Brenda muajt Gusht 2016

15 - Gjetje nga auditimi: ZVRPP Berat në **3 raste**, ka regjistruar pasuri të paluajtshme dhe ka lëshuar certifikatë pronësie për pasuri ndërtesë **pa shlyer detyrimin mbi përdorimin e truallit shtetëror në masën 10 % të vlerës së truallit**, sipas hartës përkatëse të vlerës së trojeve, në zbatim të germës c pika 1, të UMF nr. 30, datë 07.09.2010 Për zbatimin e Ligjit nr. 10 270, datë 22.4.2010 “Për të drejtën e privatizimit të truallit shtetëror në përdorim dhe për taksën mbi të drejtën e përdorimit të tij”, veprim në papajtueshmëri me nenin 42, të Ligjit nr. 33, datë 21.03.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” (*Trajtuar në faqet 197-198, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

- **Rekomandim:** Regjistruesi i ZVRPP Berat të marrë masa, që në bazë të pika 1 neni 5, pika 1 neni 49 dhe neni 59, të Ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë nr. 2/1000, volum 13, fleta 16, nr. 1/750, volum 13, fleta 3, nr. 1/729, volum 12, fleta 196, ZK 3682, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor.

Brenda muajt Gusht 2016

16 - Gjetje nga auditimi: ZVRPP Berat në **4 raste**, ka regjistruar pasuri të paluajtshme dhe ka lëshuar certifikatë pronësie për pasurinë e përfituara sipas Kontratës së shitjes nr. 7040, Rep. nr. 1547, Kol. datë 09.10.2015, për kalimin në pronësi “Objekti 1, Shtabi i Vjetër”, Ura Vajgurore, pasi në Kontratën e shitjes **nuk janë përcaktuar numri i pasurive, zona kadastrale dhe sipërfaqja e shitur** në ZK 3682 Ura Vajgurore dhe ZK 3978 Aviacion, veprim në papajtueshmëri me Ligjin nr. 33, datë 21.03.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” (*Trajtuar në faqet 200-202, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

- **Rekomandim:** Regjistruesi i ZVRPP Berat të marrë masa, që në bazë të pikës 1 neni 5, pikës 1 neni 49 dhe neni 59, të Ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë nr. 1/460, volum 5, fleta 128, nr. 1/462, volum 5, faqe 130, nr. 1/464, volum 5, faqe 132, nr. 1/753, volum 13, faqe 27, nr. 1/755, volum 13, faqe 29, ZK 3682, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor.

Brenda muajt Gusht 2016

17 - Gjetje nga auditimi: ZVRPP Berat në **3 raste**, ka regjistruar pasuri të paluajtshme dhe ka lëshuar certifikatë pronësie për pasurinë e përfituara nga ALUIZNI, pasi në **genplanin që i bashkëlidhet lejes së legalizimit nuk përcaktohet dalja nga parcel ndërtimore**, veprim në papajtueshmëri me pikën 10.6, Kreu i II, të Rregullores nr. 184, datë 08.04.1999 “Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme”, të ndryshuar dhe Udhëzimin e Kryeregjistruesit nr. 2532, datë 21.04.2009 Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme të fituar sipas Ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e zonave të ndërtimeve informale” (*Trajtuar në faqet 206-207, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

- **Rekomandim:** Regjistruesi i ZVRPP Berat të marrë masa, që në bazë të pikës 1 neni 5, pikës 1 neni 49 dhe neni 59, të Ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë nr. 4/302, volum 13, faqe 17, nr. 2/99, volum 10, faqe 215, nr. 5/309, volum 13, faqe 21, ZK 3682, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor.

Brenda muajt Gusht 2016

18 - Gjetje nga auditimi: ZVRPP Berat në **2 raste**, ka regjistruar pasuri të paluajtshme dhe ka lëshuar certifikatë pronësie për pasuritë e përfituara me vendime të gjykatës, pasi **nuk ka bërë rekurs në Gjykatën e Lartë Tiranë**. Në dosje nuk ndodhet vendimi i gjykatës, si dhe ZVRPP Berat, **nuk ka bërë ankim në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë**, kundër vendimit nr. 345, datë 24.03.2014, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, veprim në papajtueshmëri me nenin 391, 442, 443, 444, të Ligjit nr. 8116, datë 29.03.1996

“Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe pika 1, të VKM nr. 556, datë 23.10.2000 “Për dorëzimin e dokumentacionit në ZVRPP” (*Trajtuar në faqet 231-232, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

- **Rekomandim:** Regjistruesi i ZVRPP Berat të marrë masa, që në bazë të pikës 1 neni 5, pikës 1 neni 49 dhe neni 59, të Ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë nr. 2/959, volum 12, faqe 198 dhe nr. 2/74, volum 10, faqe 214, ZK 3682, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor.

Brenda muajt Gusht 2016

19 - Gjetje nga auditimi: Nga ZVRPP Berat në të **gjitha rastet**, nuk janë verifikuar elementet e formës dhe të përmbajtjes të Vendimeve të gjykatës, Akteve Noteriale dhe Akteve Administrative, si dhe nuk janë plotësuar **shtojca 1, 2, 3**, veprim në papajtueshmëri me nenin 42 dhe pika 5 neni 45, të Ligjit nr. 33, datë 21.03.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” dhe pika 4, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012 “Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit” (*Trajtuar më hollësisht në faqet 20-256, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

- **Rekomandim:** Regjistruesi i ZVRPP Berat të marrë masa, që për çdo rast në lidhje me regjistrimin e pasurive të paluajtshme të verifikojë elementët e formës dhe të përmbajtjes për pasuritë e fituar me vendim gjykatë, akte noteriale dhe akte administrative. Të plotësojë shtojcat 1, 2, 3, si dhe të shprehet me shkrim duke arsyetuar regjistrimin e pasurisë së paluajtshme ose refuzimin e tyre.

Në vijimësi

20 - Gjetje nga auditimi: Nga ZVRPP Berat në të **gjitha rastet**, nuk janë përgatitur planrilevimi për çdo pasuri që është regjistruar në kartelën e pasurisë së paluajtshme **ku të përcaktoj me vijëzim me ngjyre të kuqe pozicionin gjeografik të pasurisë**, veprim në papajtueshmëri me pikën 10.6, Kreu i II, të Rregullores nr. 184, datë 08.04.1999 “Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme”, të ndryshuar (*Trajtuar më hollësisht në faqet 20-256, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

- **Rekomandim:** Regjistruesi i ZVRPP Berat të marrë masa, që për çdo rast për pasuritë e paluajtshme si regjistrime fillestare, ndarje dhe bashkim pasurish të përgatisë planrilevimi nga hartografi i ZVRPP duke e krahasuar me planrilevimin e ardhur nga topografi me licencës.

Në vijimësi

21 - Gjetjet nga auditimi: ZVRPP Berat në **2 raste**, kartelat e pasurisë së paluajtshme janë **pa datë përfundimtare, pa nënshkrimin e Regjistruesit dhe pa vulën e ZVRPP**, në dosje nuk ndodhet Urdhri i Regjistruesit për ndarjen e pasurive të paluajtshme, veprim në papajtueshmëri me nenin 34, të Ligjit nr. 33, datë 21.03.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” (*Trajtuar në faqet 60-62, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

- **Rekomandim:** Regjistruesi i ZVRPP Berat të marrë masa, për plotësimin e kartelave të pasurisë së paluajtshme, duke bërë nënshkrimin, vulosjen dhe vendosjen e datës përfundimtare të tyre në volumin 7, faqe 87 dhe volumin 7, faqe 8, ZK 2848.

Brenda muajt Gusht 2016

22 - Gjetjet nga auditimi: ZVRPP Berat në **8 raste**, me sipërfaqe **3560 m²**, ka bërë regjistrimin e pasurisë të paluajtshme dhe ka lëshonte certifikata pronësie, pas në AMTP janë regjistruar pasuri të cilat **nuk janë përfituar me Ligjin nr. 7501, datë 17.09.1991 “Për tokën”**, veprim në papajtueshmëri me nenin 25/a, të Ligjit nr. 33, datë 21.03.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, pika 1, të UKM nr. 2, datë 13.06.2013 “Për mënyrën e procedimit të organeve të administratës publike, për pasuritë e paluajtshme, të fituara me Aktin e Marrjes së Tokës në Pronësi (AMTP)” dhe pika 5, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012

“Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruarit” (Trajtuar në faqet 61-67, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

- **Rekomandim:** Regjistruesi i ZVRPP Berat të marrë masa, që në bazë të pikës 1, neni 5, pika 1, neni 49 dhe neni 59, të Ligjit nr. 33, datë 29.04.2012, “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë nr. 36/60, volum 6, faqe 142, nr. 6/4, volum 7, faqe 8, nr. 39/26, volum 7, faqe 71, nr. 63/32, volum 7, faqe 97, nr. 36/66, volum 6 faqe 157, nr. 29/16 volum 6 faqe 158, nr. 84/60, volum 7, faqe 60, nr. 49/47, volum 7 faqe 101, nr. 49/25 volum 7 faqe 102, nr. 74/52, volum 7, faqe 104, nr. 56/29, volum 7, faqe 129, ZK 2848, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko-ligjor.

Brenda muajt Gusht 2016

23 - Gjetjet nga auditimi: ZVRPP Berat në **17 raste**, ka regjistruar në kartelën e pasurisë së paluajtshme dhe ka lëshuar certifikatë pronësie pasuri të përfituara sipas Aktit të Marrjes së Tokës në Pronësi, pasi aktit i **mungon njëra nga vulat**, si dhe është **përfituar më shumë 18,270 m²** tokë si diferencë ndërmjet (printimit III - AMTP m²), veprim në papajtueshmëri me nenin 25/a, të Ligjit nr. 33, datë 21.03.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, dhe germa ç pika 1, të UKM nr. 2, datë 13.06.2013 “Për mënyrën e procedimit të organeve të administratës publike, për pasuritë e paluajtshme, të fituara me Aktin e Marrjes së Tokës në Pronësi (AMTP)” (Trajtuar në faqet 67-72, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

- **Rekomandim:** Regjistruesi i ZVRPP Berat të marrë masa, që në bazë të pikës 1, neni 5, pika 1, neni 49 dhe neni 59, të Ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë nr. 886/72, nr. 814/9, nr. 819/4, nr. 822/10, nr. 823/14, nr. 923/4, sipas referencës nr. 0098, të përfituar nga AMTP nr. 1, datë 05.06.1992, ZK 3957, për pasurin 1785/9, volum 4, faqe 35, nr. 1079/18, volum 4, faqe 136, nr. 179/19, volum 4 faqe 137, ZK 3357, nr. 973/1, volum 3 faqe 116, nr. 831/4, volum 1, faqe 134, nr. 831/11, volum 3, faqe 92, nr. 925/27, volum 3, faqe 93, nr. 886/125, volum 3, faqe 96, ZK 3957, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko-ligjor dhe të dërgojë në Komisionin vendor të vlerësimit të titujve të pronësisë (KV) pranë Prefektit të Qarkut Berat, vlefshmërinë ligjore të AMTP nr. 26, datë 05.06.1992, nr. 4, datë 23.10.2001 dhe nr. 13, datë 05.06.1992 në lidhje me normën për frymë të vitit 1991.

Brenda muajt Gusht 2016

24 - Gjetjet nga auditimi: ZVRPP Berat në **1 rast**, ka regjistruar pasuri të paluajtshme të përfituar sipas AMTP nr. 46, datë 05.06.1992, pasi aktit i **mungon njëra nga vulat dhe është pa nënshkrimin e kryetarit të komisionit të ndarjes së tokës në fshat**, veprim në papajtueshmëri me nenin 25/a, të Ligjit nr. 33, datë 21.03.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, me pika 1, të UKM nr. 2, datë 13.06.2013 “Për mënyrën e procedimit të organeve të administratës publike, për pasuritë e paluajtshme, të fituara me Aktin e Marrjes së Tokës në Pronësi (AMTP)” (Trajtuar në faqet 69-70, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

- **Rekomandim:** Regjistruesi i ZVRPP Berat të marrë masa, që në bazë të pikës 1, neni 5, pika 1, neni 49 dhe neni 59, të Ligjit nr. 33, datë 29.04.2012, “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë nr. 814/18, volum 1, faqe 14, nr. 913/5, volum 1, faqe 228, nr. 920/7, volum 2, faqe 182, ZK 3957, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko-ligjor dhe të dërgojë në Komisionin vendor të vlerësimit të titujve të pronësisë (KV) pranë Prefektit të Qarkut Berat, vlefshmërinë ligjore të AMTP nr. 46, datë 05.06.1992 në lidhje me normën për frymë të vitit 1991.

Brenda muajt Gusht 2016

25 - Gjetje nga auditimi: ZVRPP Berat në **1 rast**, ka regjistruar në kartelën e pasurisë së paluajtshme dhe ka lëshuar certifikatë pronësie, pasuri të përfituara sipas Aktit të Marrjes së

Tokës në Pronësi **pa numër dhe pa datë**, veprim në papajtueshmëri me germën ç pika 1, të UKM nr. 2, datë 13.06.2013 “Për mënyrën e procedimit të organeve të administratës publike, për pasuritë e paluajtshme, të fituara me Aktin e Marrjes së Tokës në Pronësi (AMTP)” *(Trajtuar në faqet 70-71, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.

- **Rekomandim:** Regjistruesi i ZVRPP Berat të marrë masa, që në bazë të pikës 1 neni 5, pikës 1 neni 49 dhe neni 59, të Ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë nr. 936//67, volum 3, faqe 81, nr. 936//68, volum 3, faqe, nr. 82/82, volum 3, faqe 83, nr. 973/83, volum 3, faqe 84, nr. 973/84, volum 3. faqe 85, nr. 943/40, volum 3, faqe 72, nr. 943/41, volum 3, faqe 73, nr. 943/42, volum 3, faqe 74, ZK 2558, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko-ligjor dhe të dërgojë në Komisionin vendore të vlerësimit të titujve të pronësisë (KV) pranë Prefektit të Qarkut Berat, vlefshmërinë ligjore të AMTP në lidhje me normën për frymë të vitit 1991.

Brenda muajt Gusht 2016

26 - Gjetjet nga auditimi: ZVRPP Berat në **1 rast**, ka regjistruar pasurin e paluajtshme dhe ka lëshuar certifikatë pasurie për pasur të përfutuar sipas nenit 25/b, pasi vendimi i Regjistruesit datë 15.04.2013, është **pa numër, pa nënshkrim dhe pa vulën e ZVRPP Berat**, veprim në papajtueshmëri me pika iii, neni 25/b, të Ligjit nr. 33, datë 21.03.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” *(Trajtuar në faqet 236-237, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.

- **Rekomandim:** Regjistruesi i ZVRPP Berat të marrë masa, që në bazë të pikës 1, neni 5, pika 1, neni 49 dhe neni 59, të Ligjit nr. 33, datë 29.04.2012, “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë nr. 15/445, volum 25, faqe 94, ZK 8501, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko-ligjor.

Brenda muajt Gusht 2016

27 - Gjetjet nga auditimi: ZVRPP Berat në **1 rast**, ka regjistruar pasurinë e paluajtshme dhe ka lëshuar certifikatë pasurie për pasur të fituara me vendimin nr. 18, datë 13.03.1994, të KRRT-së, pasi në vendim **nuk është përcaktuar sipërfaqja e sheshit dhe sipërfaqja e ndërtimit**, Akt kolaudimi i objektit është **pa datë** dhe nuk është përcaktuar sipërfaqja e strukturës ndërtimore, veprim në papajtueshmëri me pika 1 neni 48, të Ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” dhe pika 5, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012 *(Trajtuar në faqet 166-167, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.

- **Rekomandim:** Regjistruesi i ZVRPP Berat të marrë masa, që në bazë të pikës 1, neni 5, pika 1, neni 49 dhe neni 59, të Ligjit nr. 33, datë 29.04.2012, “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë nr. 13/124-DN, volum 25, faqe 71, ZK 8501, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko-ligjor.

Brenda muajt Gusht 2016

28 - Gjetjet nga auditimi: ZVRPP Berat në **1 rast**, ka regjistruar në kartelën e pasurisë së paluajtshme dhe ka lëshuar certifikatë pronësie për pasuri të fituar nga bashkimi i pasurisë nr. 13/391, volum 22, faqe 189 dhe të pasurisë nr. 13/391, volumi 23, faqe 219, pasi mungon urdhri i Regjistruesit, ndërsa në dosje **nuk ndodhet leja e ndërtimit**, veprim në papajtueshmëri me nenin 34 dhe pika 1 neni 48, të Ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” dhe pika 12, të Rregullores nr. 184, datë 08.04.1999 “Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme”, të ndryshuar *(Trajtuar në faqet 167-169, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.

- **Rekomandim:** Regjistruesi i ZVRPP Berat të marrë masa, që në bazë të pikës 1, neni 5, pika 1, neni 49 dhe neni 59, të Ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë nr. 15/591, volum 23, faqe 219, ZK 8501, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko-ligjor.

Brenda muajt Gusht 2016

29 - Gjetjet nga auditimi: ZVRPP Berat në **1 rast**, ka regjistruar në kartelën e pasurisë së paluajtshme dhe ka lëshuar certifikatë pronësie për pasurinë nr. 10/50, volum 7, faqe 110 pasi KPP nuk është nënshkruar nga specialisti përkatës, pasi akti **nuk përmban njëzëri nga vulat**, si dhe **4 pasuri me sipërfaqe 7,104 m² janë pa kufizime**. Pasuritë nuk janë regjistruar sipas AMTP-së por janë regjistruar sipas (printimit III) me sipërfaqe 10,638 m², **duke regjistruar më shumë 3,534 m²**, veprim në papajtueshmëri me nenin 25/a, të Ligjit nr. 33, datë 21.03.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” (*Trajtuar në faqet 60-87, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

- **Rekomandim:** Regjistruesi i ZVRPP Berat të marrë masa, që në bazë të pika 1, neni 5, pika 1, neni 49 dhe neni 59, të Ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë nr. 10/2, volum 1, faqe 9, nr. 66/141, volum 4, faqe 50, nr. 74/126, volum 5, faqe 246, nr. 74/127, volum 5, faqe 247, nr. 81/10, volum 5, faqe 93 dhe nr. 10/50 volum 7, fleta 110, ZK 2848, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko-ligjor.

Brenda muajt Gusht 2016

30 - Gjetjet nga auditimi: ZVRPP Berat në **1 rast**, ka regjistruar pasurinë e paluajtshme dhe ka lëshuar certifikatë pronësie për pasuri të përfituar sipas AMTP nr. 25, datë 25.11.1992, me sipërfaqe 11,445 m², i cili është akt **në përdorim**. Këshilli i Qarkut Berat me shkresë datë 24.11.2014, konfirmon se nuk ka ndryshim në zëra dhe në sipërfaqen e AMTP nr. 25, datë 25.11.1992. Nga punonjësit e TAP AG në kartelën e pasurisë së paluajtshme janë kryer veprime për pasurinë nr. 84/65, volum 7, faqe 107, **duke ja hequr pronarit dhe duke e kaluar në pronësi shtet**, veprim në papajtueshmëri me pika 1 neni 63, të Ligjit nr. 33, datë 21.0.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” (*Trajtuar në faqet 84-85, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

- **Rekomandim:** Regjistruesi i ZVRPP Berat të marrë masa, që në bazë të pikës 1, neni 5, pika 1, neni 49 dhe neni 59, të Ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë nr. 84/65, volum 7 faqe 107, ZK 2848, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko-ligjor.

Brenda muajt Gusht 2016

31 - Gjetje nga auditimi: ZVRPP Berat në **1 rast**, ka regjistruar pasurinë e fituar sipas vendimit të komisionit të kthimit dhe të kompensimit të pronave ish-pronarëve të Këshillit të Rrethit Berat me sipërfaqe 4,750 m², pasi **mungon planvendosja** dhe nuk është plotësuar **shtojca 3**, veprim në papajtueshmëri me Rregulloren nr. 184, datë 08.04.1999 “Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme”, pika 5, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012 “Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruarit” të ndryshuar (*Trajtuar në faqet 24-25, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

- **Rekomandim:** Regjistruesi i ZVRPP Berat të marrë masa, që në bazë të pikës 1, neni 5, pika 1, neni 49 dhe 59, të Ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë nr. 1152/1, volum 9 faqe 248, ZK 2723, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko-ligjor.

Brenda muajt Gusht 2016

32 - Gjetje nga auditimi: ZVRPP Berat në **1 rast**, ka regjistruar në kartelën e pasurisë së paluajtshme dhe ka lëshuar certifikatë pasurie për pasuri të përfituara sipas AMTP nr. 125, datë 10.05.1994, pasi **mungon njëra nga vulat**, si dhe duke **përfituar më shumë tokë bujqësore 2,100 m²** se veprim në papajtueshmëri me nenin 25/a, të Ligjit nr. 33, datë 21.03.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, germa ç pika 1, të UKM nr. 2, datë 13.06.2013 “Për mënyrën e procedimit të organeve të administratës publike, për pasuritë e

paluajtshme, të fituara me Aktin e Marrjes së Tokës në Pronësi (AMTP)” (Trajtuar në faqet 92-93, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

- **Rekomandim:** Regjistruesi i ZVRPP Berat të marrë masa, që në bazë të pikës 1, neni 5, pika 1, neni 49 dhe neni 59, të Ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë nr. 1237/23, volum 3, faqe 110, nr. 1218/2, volum 2 faqe 216, nr. 1550/2, volum 7 faqe 229, ZK 2723, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko-ligjor.

Brenda muajt Gusht 2016

33 - Gjetje nga auditimi: ZVRPP Berat në **1 rast**, ka regjistruar pasurinë e paluajtshme dhe ka lëshuar certifikatë pronësie duke **ndryshuar zërin kadastral nga rrugë në tokë Arë** me sipërfaqe **2,000 m²**, veprim në papajtueshmëri me nenin 25/a, të Ligjit nr. 33, datë 21.03.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” dhe pika 5, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012 “Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruarit” (Trajtuar në faqet 93, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

- **Rekomandim:** Regjistruesi i ZVRPP Berat të marrë masa, që në bazë të pikës 1, neni 5, pika 1, neni 49 dhe neni 59, të Ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë nr. 1298/1, volum 10 faqe 152, ZK 2723, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko-ligjor.

Brenda muajt Gusht 2016

34 - Gjetje nga auditimi: ZVRPP Berat në **1 rast**, është regjistruar Deklarata noteriale nr. 1030/424, datë 02.07.2015, ndërsa sipas planrilevimit janë kryer ndryshime në sipërfaqet e pasurive, pasi një pjesë e pasurisë nr. 1237/149, arë me sipërfaqe 700 m² i ka kaluar pasurisë nr. 1237/148, arë me sipërfaqe 1,084 m², veprim në papajtueshmëri me nenin 63, të Ligjit nr. 33, datë 21.03.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” (Trajtuar në faqet 94-95-76, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

- **Rekomandim:** Regjistruesi i ZVRPP Berat të marrë masa, që në bazë të pikës 1, neni 5, pika 1, neni 49 dhe neni 59, të Ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë sipas pasqyrës nr. 1/1, në Raportin Përfundimtar të Auditimit, ZK 2723, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko-ligjor.

Brenda muajt Gusht 2016

35 - Gjetje nga auditimi: ZVRPP Berat në **1 rast**, ka regjistruar në kartelën e pasurisë së paluajtshme dhe ka lëshuar certifikatë pronësie për pasuri të fituara sipas AMTP nr. 92, datë 04.04.1995, si dhe duke përfituar **tokë bujqësore më shumë 5,875 m²**, se veprim në papajtueshmëri me nenin 25/a, të Ligjit nr. 33, datë 21.03.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” (Trajtuar në faqet 94-95-76, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

- **Rekomandim:** Regjistruesi i ZVRPP Berat të marrë masa, që në bazë të pikës 1, neni 5, pika 1, neni 49 dhe neni 59, të Ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë sipas pasqyrës nr. 1/1, në Raportin Përfundimtar të Auditimit, ZK 2723, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko-ligjor.

Brenda muajt Gusht 2016

36 - Gjetje nga auditimi: ZVRPP Berat në **1 rast**, ka regjistruar në kartelën e pasurisë së paluajtshme pasurinë e cila në kartelën e pasurisë së paluajtshme dhe në planrilevimin e përgatitur nga topografi me licencë mbajnë indeksin e hartës (190-B), ndërsa në planshetin që ndodhet në ZVRPP Berat, kjo pasuri mban indeksin e hartës (190-A), **pra duke krijuar zhvendosje të pasurisë**, veprim në papajtueshmëri me germën **c**, pika 1 e nenit 64, të Ligjit nr. 33, datë 21.03.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” (Trajtuar në faqet 94-95-76, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

- **Rekomandim:** Regjistruesi i ZVRPP Berat të marrë masa, që në bazë të pikës 1, neni 5, pika 1, neni 49 dhe neni 59, të Ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë sipas pasqyrës nr. 1/1 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, ZK 2723, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko-ligjor.

Brenda muajt Gusht 2016

37 - Gjetje nga auditimi: ZVRPP Berat në **1 rast**, ka regjistruar në kartelën e pasurisë së paluajtshme dhe ka lëshuar certifikatë pronësie për pasuri të fituara me Aktin e Marrjes së Tokës në Pronësi nr. 45, datë 18.12.1994, pasi akti **nuk përmban njërën nga vulat**, si dhe nuk është plotësuar **shtojca 3**, veprim në papajtueshmëri me pika 5, të UKM nr. 1, datë 31.01.2007, të ndryshuar me UKM nr. 2, datë 12.09.2012 “Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruarit” (*Trajtuar në faqet 95-96, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

- **Rekomandim:** Regjistruesi i ZVRPP Berat të marrë masa, që në bazë të pikës 1, neni 5, pika 1, neni 49 dhe neni 59, të Ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë nr. 1130/4, volum 6 faqe 116, nr. 1224/65, volum 9 faqe 163, nr. 1124/79, volum 11 faqe 36, nr. 1124/80, volum 11 faqe 37, nr. 1133/2, volum 1 faqe 207, nr. 1135/10, volum 9 faqe 166, nr. 1135/11, volum 10 faqe 140, nr. 1135/12, volum 10 faqe 141, ZK 2723, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko-ligjor.

Brenda muajt Gusht 2016

38 - Gjetje nga auditimi: ZVRPP Berat në **18 raste**, ka regjistruar pasuritë e paluajtshme dhe ka lëshuar certifikata pronësie për pasuritë e përfituar me AMTP, pasi **nuk përmbajnë njërën nga vulat**, veprim në papajtueshmëri me germën **ç**, pika 1, të UKM nr. 2, datë 13.06.2013 “Për mënyrën e procedimit të organeve të administratës publike, për pasuritë e paluajtshme, të fituara me Aktin e Marrjes së Tokës në Pronësi (AMTP)” dhe pikën 5, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012 “Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruarit” (*Trajtuar në faqet 71-76, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

- **Rekomandim:** Regjistruesi i ZVRPP Berat të marrë masa, që në bazë të pikës 1, neni 5, pika 1, neni 49 dhe neni 59, të Ligjit nr. 33, datë 29.04.2012, “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë sipas pasqyrës nr. 2 në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

Brenda muajt Gusht 2016

39 - Gjetje nga auditimi: ZVRPP Berat në **1 rast**, ka regjistruar pasurinë e paluajtshme të fituar sipas lejes së ndërtimit, pasi **mungojnë marrëdhëniet me truallin**, Akt Kolaudimi është **pa datë** dhe nuk përcakton **sipërfaqen ndërtimore**, veprim në papajtueshmëri me pikën 1 neni 48, të Ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” (*Trajtuar në faqet 92-93, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

- **Rekomandim:** Regjistruesi i ZVRPP Berat të marrë masa, që në bazë të pikës 1, neni 5, pika 1, neni 49 dhe neni 59, të Ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë nr. 1219/59, volum 9 faqe 240, ZK 2723, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko-ligjor.

Brenda muajt Gusht 2016

40 - Gjetje nga auditimi: ZVRPP Berat në **1 rast**, ka regjistruar në kartelën e pasurisë së paluajtshme dhe ka lëshuar certifikatë pronësie për pasuri të fituara me leje ndërtimi, **në mungesë të vendimit të KRRT-së** për miratimin e lejes së sheshit të ndërtimit dhe të kondicioneve urbane të tij (formulari nr. 2), projektit dhe **planvendosjes së objektit**, veprim në papajtueshmëri me pikën 1 neni 48, të Ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, me nenin 13, të Ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe

disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar dhe UKM nr. 2, datë 12.09.2012 “Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit” (*Trajtuar në faqet 177-178, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

- **Rekomandim:** Regjistruesi i ZVRPP Berat të marrë masa, që në bazë të pikës 1, neni 5, pika 1, neni 49 dhe neni 59, të Ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë nr. 150/132 volum 18 faqe 128, ZK 2723, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko-ligjor.

Brenda muajt Gusht 2016

41 - Gjetje nga auditimi: ZVRPP Berat në **1 rast**, ka regjistruar pasurinë e paluajtshme dhe ka lëshuar certifikatë pronësie, duke kryer korrigjimin e sipërfaqes së truallit nga 341 m² në sipërfaqen 118 m² dhe ndërtesë 48 m² (341 - 118 = 223 m²), ndërsa **sipërfaqja 223 m², nuk është ndarë dhe nuk është regjistruar në KPP**, veprim në papajtueshmëri me nenin 25/a, të Ligjit nr. 33, datë 21.03.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” (*Trajtuar në faqet 192-193, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

